



DREJTORIA PËR SPORT
Nr. 16-111/01-166538/21, dt. 16 AUG 2021

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", më 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 29.1.3, shkronja d, të Rregullores së ndarjes së subvencioneve 01-020/01-19410/18 të dt. 08.08.2018, Vendimit të Kryetarit të Komunës nr. 14-022/01-157209/21 të dt. 04.08.2021 Drejtoria për Sport shpall:

K O N K U R S

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR SHPRESAT E SPORTIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I. Komuna e Prishtinës ndanë bursa për shpresat e sportit të Komunës së Prishtinës, për vitin 2021, me vlerë **1000 Euro**, në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë konkurs si;

II. KRITERET E PËRGJITHSHME:

1. Të jetë i regjistruar si sportist në një klub të pranuar nga federata përkatëse;
2. Të mos jetë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
3. Të jetë banor i Komunës së Prishtinës;
4. Të jetë sportist me moshë 15-21 vjeç.

III. KRITERET E VEÇANTA:

1. Fitues nga Kampionatet/Garat Botërore të sporteve përkatëse, vlerësohet me 60 pikë;
2. Fitues nga Kampionatet/ Garat Evropiane të sporteve përkatëse, vlerësohet me 50 pikë;
3. Fitues nga Kampionatet/Garat Ballkanike të sporteve përkatëse, vlerësohet me 30 pikë;
4. Fitues nga Kampionatet/Garat Vendore të sporteve përkatëse, vlerësohet me 20 pikë;
5. Përfaqësues i Kosovës për grupmosha të caktuara, vlerësohet me 20 pikë;

6. Nxënësit/Studentët në asistencë sociale vlerësohen me 10 pikë.
7. Pjesëmarrës në gara ndërkombëtare, vlerësohet me 5 pikë;
8. Sipas kategorizimit të sporteve, vlerësohet me 10 pikë nga kategoria A, me 8 pikë nga kategoria B, me 6 pikë nga kategoria C dhe me nga 4 pikë nga kategoria D;
9. Nota mesatare e mësimëve/studimeve, vlerësohet me 5-10 pikë (Nota 2/6, gjashtë pikë, nota 3/7, shtatë pikë, nota 4/8, tetë pikë, nota 5/9, nëntë pikë, studentet vlerësohen me 10 (dhjetë) pikë ;

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në piken III, do të kenë përparësi nxënësit/studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, që nuk e kanë prindin në jetë dhe studentët që udhëtojnë nga fshati me larg se 15 km (Kritere të cilat duhen të dëshmohen).

IV. DOKUMENTET E DOMOSDOSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-së, së sportistit;
3. Certifikata e notave;
4. Deklarimi i nënshkruar se nuk është përfitues i ndonjë burse tjetër nga institucionet relevante;
5. Certifikata/Ekstrakti i lindjes;
6. Dëshmi për arritjet në fushën përkatëse të sportit;
7. Kopja e letërnjoftimit/pasaportës;
8. Vërtetimi nga administrata tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune (për personat mbi moshën 18 vjeçare);

Vërejtje: Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë punenga dita e shpalljes. Aplikacioni merret dhe i plotësuar dorëzohen në sportelet e katit përdhës të Komunës të Pishinës (ndërtesa e vjetër), çdo ditë pune prej orës **10:00 deri 15:00**.


Fitim Rexha
Drejtor për Sport

Faqe 2 nga 2